

VENDIM
Nr. 133, datë 3.3.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
HARTIMIT TË PROJEKTIT TË PARKUT DHE KOMPLEKSIT SPORTIV, NË
ZONËN E RE PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA
KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 37 837 121 (tridhjetë e shtatë milionë e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e një) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit të parkut dhe kompleksit sportiv, në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t'i kalojë Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese, për zbatimin e pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe